# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

**KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE**

**MAJ, VITI MËSIMOR 2019/20**

# UDHËZIM PËR VLERËSIM

**VËREJTJE: Gabimet në gramatikë duhet anashkaluar, vetëm nëse është qëllimi i detyrës kontrollimi i rregullës së caktuar gramatikore ose drejtshkrimore.**

**DETYRA 1**: është rrethuar numri 2- përzierja për përgatitjen e ushqimit

***1 pikë***

**DETYRA 2**: Nxënësi/nxënësja* merr ***1 pikë*** nëse ka rrethuar shkronjën P dhe ka shkruar: Spagetat zihen 8 deri në 10 minuta, dhe është e nevojshme që të skuqet mishi shtesë rreth 5 minutash dhe pastaj të zihet në një temperaturë të lehtë rreth 10 minutash. *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*

***Vërejtje:***

1. Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse nuk e ka rrethuar shkronjën P (dhe as shkronjën S), por e ka argumentuar saktë.
2. Nxënësi merr **0 pikë** nëse ka rrethuar S, megjithëse shpjegimi është i saktë.

**DETYRA 3:** nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: www.shijet.com

***1 pikë***

**DETYRA 4:** është rrethuar numri 2- Të paralajmërojë personat alergjik në

***1 pikë***

**DETYRA 5:** nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: 53 gram/ 53 g/ 53 *(pranohet edhe përgjigjja e përshkruar nga figura)*

***1 pikë***

**DETYRA 6:** nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: dashuria, lumturia, iluzioni, humbja, familja, atdheu...

***1 pikë***

**DETYRA 7:** nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: Kënga nis me përshkrimin e natyrës në perëndim

***1 pikë***

---

*Në tekstin e mëtejshëm nxënësi

**DETYRA 8:** nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar për portretin fizik: ballët e zbuluar, gjifryrë..., me gërsheta të pleksur, e përveshur e e lartë, etj.; Për portretin moral-shpirtëror: trembur hare, çeret të ndezur etj.

***1 pikë***

**DETYRA 9:** është rrethuar numri 1- tetërrokësh

***1 pikë***

**DETYRA 10:** nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: Trimi : - Vajzë, a m`ep ti një pike ujë?/ Vajza: - Sa te duash t`i, bir zoti*...(ose ndonjë varg tjetër i dialogut)*

**DETYRA 11:** gjithsej **2 pikë:**

**A)** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: krahasimin

**B)** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: Poeti me figurën e krahasimit dëshiron të thotë se dielli dhe natyra janë burim i jetës. *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*

***Vërejtje:***

Nëse përgjigjja nën A është e pasaktë, nuk pranohet përgjigjja nën B, pa marrë parasysh edhe nëse është e saktë.

**DETYRA 12:** nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar për: mbaruar – përfunduar dhe për përveshur-shpërvjelur, qasur, filloi nga puna *(dhe përgjigje të tjera të sakta)*

***1 pikë***

**DETYRA 13:** nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: *emër (e ndryshueshme)*

***1 pikë***

**DETYRA 14:** gjithsej **2 pikë**: nga ***1 pikë*** për përgjigje plotësisht të saktë:

| PERSONAZHI LETRAR | VEPRA | LLOJI LETRAR |
|---|---|---|
| Zhuljeta | ***Romeo dhe Zhuljeta*** | **tragjedi** |
| Hilush Vilëza | *Tregtar flamujsh* | *novelë* |
| Zonja mëmë | *Këngët e Milosaut* | *poemë epiko-lirike* |

# GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI

**KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES NË FUND TË CIKLIT III TË SHKOLLËS FILLORE**
**MAJ, VITI MËSIMOR 2019/20**

***Vërejtje:***
*Në test është bërë një lëshim teknik dhe në vend se të jetë novelë ka mbetur roman nga varianti i mëparshëm i detyrës. Ashtu që ta keni parasysh këtë dhe nxënësve t'u pranohet një pikë tek Hilush Vilëza-Tregtarë flamujsh-novelë, pa marrë parasysh përgjigjen e tyre.*

**DETYRA 15:** gjithsej **2 pikë:**
Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar saktë mënyrën e foljes: lidhore

Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar saktë kohën e foljes: e pakryer

**DETYRA 16:** gjithsej **4 pikë:**

1. Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse fjalët nga kllapat i ka përdorur në trajtën e duhur: Shikonim si **ekskavatorët e mëdhenj të verdhë** e gërryenin tokën.

   Nxënësi merr ***1 pikë*** për caktimin e rasës:
   rasa – **emërore**.

2. Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse fjalën nga kllapat e ka përdorur në trajtën e duhur: Pjesën dërmuese të pushimit e kemi kaluar në **Podgoricë**.

   Nxënësi merr ***1 pikë*** për caktimin e rasës:
   rasa – **kallëzore**.

**DETYRA 17:** gjithsej **2 pikë**
**A)** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: *"Kur shikojmë këto kostume na duket sikur parakalojmë krahinat e ndryshme të Shqipërisë: Malësia e Madhe, Zadrima, Kukësi, Dardha, Myzeqeja, Tirana, Dropulli.". /* Gabimi është tek vendosja e dy pikave pas emrit Shqipërisë.

**B)** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: Dy pikat vihen sepse numërojmë një varg gjymtyrësh homogjene.

**DETYRA 18:** gjithsej **2 pikë**
**A)** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: *Shikuesi ka qenë i ngazëllyer me shfaqjen*.

**B)** Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka shkruar: Ne gjithmonë do t'i gëzoheshim ardhjes së tezes.

**DETYRA 19:** nxënësi merr ***1 pikë*** nëse ka rrethuar P dhe ka shkruar: Kryen funksionin e rrethanorit të mënyrës.

***Vërejtje:***
1. Nxënësi merr ***1 pikë*** nëse nuk ka rrethuar shkronjën P (dhe as shkronjën S), por e ka argumentuar saktë.
2. Nxënësi merr **0 pikë** nëse ka rrethuar S, megjithëse shpjegimi është i saktë

**DETYRA 20.**
Skema për vlerësimin e hartimit ***Shtëpia familjare e gjyshit***
**Përmbajtja – 10 pikë**

**Kërkesa 1.**
Nxënësi merr 1 pikë nëse përmend rëndësinë e familjes për çdo individ.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.
***Gjithsej 2 pikë***

**Kërkesa 2.**
Nxënësi merr 1 pikë nëse e përshkruan shkurtimisht pamjen e jashtme të shtëpisë/ banesës së gjyshit.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.
***Gjithsej 2 pikë***

**Kërkesa 3.**
Nxënësi merr 1 pikë nëse e përshkruan shkurtimisht diçka dhe/ose dikë lidhur me shtëpinë/banesën e gjyshit (ndonjë send, kujtim të dashur, njeri të dashur...).

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.
***Gjithsej 2 pikë***

**Kërkesa 4.**
Nxënësi merr 1 pikë nëse e përshkruan shkurtimisht ndjenjën/ndjenjat lidhur me ndonjë ngjarje në shtëpinë/banesën e gjyshit.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.
***Gjithsej 2 pikë***

**Kërkesa 5.**
Nxënësi merr 1 pikë nëse shkruan sa ka rëndësi për të shtëpia/banesa e gjyshit.

Nëse jep një përgjigje më të plotë dhe më me stil, merr 2 pikë.
***Gjithsej 2 pikë***

**Gjuha dhe struktura e tekstit - 8 pikë**

| **Leksiku** | **Saktësia gjuhësore** | **Lidhshmëria** | **Struktura e tekstit** |
|---|---|---|---|
| → të shprehurit e qartë dhe të saktë, zgjedhja përkatëse e fjalëve, leksiku i pasur<br><br>***2 pikë***<br><br>→ të shprehurit e qartë dhe të saktë, leksiku i varfër dhe përsëritja e shprehjeve | GRAMATIKA<br>→ respektimi i normës gramatikore (përdorimi i drejtë i rasave, formave gramatikore, kongruencës)<br>***2 pikë***<br><br>DREJTSHKRIMI<br><br>→ respektimi i normës drejtshkrimore (përdorimi i drejtë i shkronjës së madhe në fillim të fjalisë dhe i shenjave bazë të pikësimit, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe | → renditja e natyrshme e të dhënave të ofruara, lidhshmëria e mirë në nivelin e tekstit dhe pjesëve të tij<br>***1 pikë***<br><br>→ s' është i lidhur në nivel të tekstit dhe pjesëve të tij<br>**0 pikë** | → përshtatja e organizimit të përgjithshëm dhe formës së tekstit strukturës së tij logjike<br><br>***1 pikë*** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| **pjesërisht e saktë**<br><br>***1 pikë*** | ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit)<br><br>***2 pikë***<br><br>***Gjithsej 4 pikë***<br>GRAMATIKA<br><br>→ respektimi i normës gramatikore me gabime të vogla (p.sh. gabimet semantike...)<br><br>**pjesërisht e saktë**<br>***- 1 pikë***<br>DREJTSHKRIMI<br><br>→ respektimi i normës drejtshkrimore me gabime të vogla (gabimet e vogla në shenjat e pikësimit: presja te fjalitë e ndërmjetme, inversioni, te fjalitë bashkërenditëse dhe nënrenditëse, respektimi i rregullave për shkrimin bashkë dhe ndaras të fjalëve, si dhe për ndarjen e fjalëve në fund të rreshtit)<br>**pjesërisht e saktë**<br>***- 1 pikë*** | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | ***Gjithsej 2 pikë*** | | |